

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 078

SHKATHTËSITË E BUTA NË KURRIKULËN SHKOLLORE

Tipi i programit: Themelor

Hyrje:

Shkathtësitë e buta janë pjesë e pandashme e zhvillimit të plotë të kompetencave mësimore. Kurrikula shkollore, përmes planprogrameve të fushave dhe lëndëve mësimore, planifikon zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive konkrete të lidhura me përmbajtje të caktuara. E megjithatë, janë pikërisht shkathtësitë e buta ato elemente të kompetencave, të cilat mbeten zakonisht të parealizuar mirë e shpesh nuk trajtohen fare me nxënësit. Këtu përfshihen shkathtësi të cilat ndihmojnë zhvillimin e qëndrimeve, vlerave dhe rutinave pozitive të nxënësit. Në formimin e mirëfilltë të personalitetit të nxënësit mund të ndikohet vetëm nëse përdoret një qasje e plotë/holistike gjatë zhvillimit të kompetencave kryesore mësimore.

Programi i trajnimit “Zhvillimi i shkathtësive të buta në kurrikulën shkollore” u konceptua në vitin 2017, në kuadër të programit ASSET të USAID, që u implementua nga KEC në partneritet me disa partnerë ndërkombëtarë. Programi u aprovua nga KShLM për herë të parë në mars të vitit 2020, për një vit, pastaj është ri-aprovuar edhe për tri vite tjera. Janë mbi 500 mësimdhënës të certifikuar në këtë program trajnimi.

Në vitin 2026, programi i është nënshtruar një procesi të rishikimit, për të përfshirë zhvillimet më të reja në arsim dhe për t’iu përshtatur sa më mirë nevojave të mësimdhënësve në Kosovë.

Qëllimi i programit dhe rezultatet e pritura:

Qëllimi i këtij programi është që të vetëdijesojë mësimdhënësit për nevojën e zhvillimit, vlerësimit dhe raportimin e arritjes së shkathtësive të buta të nxënësit të tyre, dhe të aftësojë ata në zhvillimin, vlerësimin dhe raportimin e këtyre shkathtësive përmes instrumenteve të caktuara.

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, mësimdhënësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të buta tek nxënësit;
- Njohin përshkruesit e shkathtësive të buta dhe treguesit për secilën shkathtësi;

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 3

- Zbatojnë instrumentet për vlerësimin e shkathtësive të buta (mbajnë librin e shënimeve për vrojtimin e nxënësve gjatë procesit mësimor; përcaktojnë kriteret e suksesit të nxënësit për një detyrë; sigurohen se nxënësit bëjnë vetëvlerësim përmes instrumentit të vetëvlerësimit);
- Përdorin instrumentet përmbledhëse për vlerësim të shkathtësive të buta të secilit nxënës dhe i dokumentojnë ato;
- Bashkëpunojnë me kolegët tjerë mësimdhënës duke vlerësuar nxënësit në ekipe, gjatë plotësimit të instrumenteve përmbledhëse të shkathtësive të buta.

Përmbajtja

Programi i këtij trajnimi përmban një pako prej dhjetë “shkathtësive të buta” apo “shkathtësive për jetë dhe punë” të cilat lidhen me jetën dhe punën e individit, përmes të cilave do të kontribuohet në zhvillimin e gjashtë kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën e Kosovës.

Në literaturë mund të gjendet një listë më e gjatë e shkathtësive të buta, dhe relevanca e tyre mund të jetë e ndryshme në kontekste të ndryshme kohore dhe vendore. Në kuadër të këtij programi trajnues janë përzgjedhur për t’u trajtuar dhjetë prej shkathtësive të buta, sepse këto ndërlidhen më afër me kompetencat kryesore të kurrikulës së vendit tonë dhe gjithashtu konsiderohen ende shumë relevante në kontekst më të gjerë të kohës. Këto shkathtësi janë:

1. Mendimi kritik
2. Komunikimi
3. Zgjidhja e problemeve
4. Kreativiteti
5. Inteligjenca emocionale
6. Ndërgjegjshmëria
7. Këmbëngulësia
8. Puna ekipore
9. Mbledhja e informatave (hulumtimi)
10. Ndërmarrësia.

Programi i trajnimit shpaloset duke i trajtuar këto shkathtësi radhazi dhe duke u përqendruar në vlerësimin e tyre përmes instrumenteve të zhvilluara.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 3

Grupi i synuar

Programi është i përshtatshëm të ofrohet për të gjithë mësimdhënësit e arsimit parauniversitar. Sipas kornizës së kurrikulës për arsim parauniversitar, të gjithë mësimdhënësit do të duhej të kenë njohuri për zhvillimin dhe vlerësimin e gjashtë kompetencave kryesore të kurrikulës, prandaj ky program i ndihmon të gjithë mësimdhënësit që janë në shërbim në arsimin parauniversitar.

Si shtesë, programi mund të ofrohet edhe për koordinatorët e cilësisë në shkolla.

Forma e organizimit/kohëzgjatja

Ky program trajnimi ofrohet përmes një kombinimi të trajnimit me prezencë fizike dhe zhvillimit profesional në vendin e punës. Metodatat e punës përfshijnë ndërveprim, plane mësimore/projekte mësimore, realizim me nxënës, prezantime, diskutime, punë individuale dhe punë në ekip me kolegët tjerë mësimdhënës. Tërë procesi i trajnimit shtrihet në afat kohor prej 4-6 javësh. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mbështeten nga trajnerët e programit, që të përkrahen në përmbushjen e kërkesave për certifikim.

Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 20 orë (12 orë trajnimi si dhe 8 orë zhvillimi përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit;
- Realizimi i instrumenteve të vlerësimit me nxënës sipas udhëzimeve nga trajnimi;
- Prezantimi i raportit të vlerësimit gojarisht para trajnerëve dhe pjesëmarrësve të trajnimit.

Materialet e trajnimit

Dokumenti kryesor për trajnimin është udhëzuesi për trajnerë, i përkrahur me fletat e punës, me prezantimin në Power Point sipas ditëve të trajnimit dhe video-prezantimet. Materiali i këtij trajnimi po ashtu përmban edhe instrumentet, që u jepen mësimdhënësve për përdorim në klasë, si dhe një instrument i vetëvlerësimit i cili do të përdoret nga vet nxënësit, që këta ta përcjellin zhvillimin e tyre personal në mënyrë të matshme përmes treguesve të caktuar.